

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR 4206 REP
NR 1100 KOL
Notere Dhimitra Qarri



Adresa: Blv "Bajram Curri", pallatet "1 Maji", shk 3, ap 24, përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.
Tel: 0692095571/0698667960/251200; e-mail: dhqarri@yahoo.com

KONTRATË SHITJE PJESËSH TË KAPITALIT THEMELTAR

Sot më datë 21/10.2016 (të vitit dymijë gjashtëmbëdhjetë), përpara meje noterit publik Dhimitra Qarri anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me zyrë noteriale, në Blv "Bajram Curri", pallatet "1 Maji", Shk 3, Ap 24, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme:

PALA SHITËSE

Edmond Hoxha, i biri i Selimit, datëlindja 28.07.1953, lindur në Patos-Fier dhe banues në Tiranë, rruga «Vaso Pasha», pall.25, shk.1, ap. 8/1, kati i pestë, i njohur personalisht prej meje noteres dhe titullar i letërnjoftimit me nr personal F30728066P.

Merita Hoxha, atësia Haki, datëlindja 04.09.1955, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, rruga «Vaso Pasha», pall.25, shk.1, ap. 8/1, kati i pestë, e njohur personalisht prej meje noteres dhe titullare e letërnjoftimit me nr personal F55904085P(bashkëshortja).

PALA BLERËSE

Elda Xibraku, atësia Bajram, datëlindja 15.07.1983, lindur dhe banues në Tiranë, Blv "Gjergj Fishta", Kulla 9, ap 29, për identitetin e së cilës u sigurova nga letërnjoftimi me nr 024493682 dhe nr personal I35715060V.

Madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët me vullnet të lirë e të plotë kërkuan përpilimin e kësaj kontrate:

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Pala shitëse është bashkëortake në shoqërinë "Superior Klima" sh.p.k. e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër NIPT K91712015L, zotëruese e 75% të kuotave të kapitalit themeltar të saj. Kapitali themeltar i shoqërisë është 5.380.000,00 lekë (pesë milionë e treqind e tetëdhjetë mijë lekë). Pala shitëse zotëron 75% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Pala shitëse dëshiron t'i shesë palës blerëse dhe pala blerëse pranon të blejë nga pala shitëse të gjitha kuotat prej 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të zotëruara nga pala shitëse në shoqëri.

NENI 2

ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGISËS

Pala shitëse shet të gjitha kuotat e kapitalit themeltar që zotëron në shoqëri, prej 75%, kundrejt çmimit në total 4,035,000.00 lekë (katër milion e tridhjetë e pesë mijë lekë).

Çmimi i shitjes që pala blerëse do t'i paguajë palës shitëse, është 4,035,000.00 lekë (katër milion e tridhjetë e pesë mijë lekë).



Palët deklarojnë se çmimi i blerjes është likuiduar totalisht me bankë, në monedhën EURO në vlerën ekuivalente me kursin 1 Euro = 140 lekë. Pala shitëse deklaron se e ka marrë në dorëzim shumën prej 28,822 (njëzet e tetë mijë e tetëqind e njëzet e dy) Euro dhe se nuk ka asnjë pretendim as sot e as në të ardhmen në lidhje me këtë shumë.

NENI 3 TRANSFERIMI KAPITALIT

Ë drejta e pronësisë mbi 75% të kuotave të kapitalit themeltar që shiten, objekt i kësaj kontrate, kalon nga pala shitëse tek pala blerëse në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, pala blerëse bëhet zotëruese e 100 % të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë me gjendjen e të aktivitetit pasivitet dhe aseteve të shoqërisë në këtë datë.

NENI 4 DEKLARATA DHE GARANCI

1. Pala shitëse deklaron dhe garanton palën blerëse se është pronare e vetme dhe e ligjshme e pjesëve që i shet palës blerëse, të cilat janë plotësisht të nënshkruara dhe të paguara;
2. Pala blerëse, bashkëortake në shoqëri, zotëruese e 25% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë, pas verifikimeve të kryera, në dokumentat financiare të shoqërisë deklaron se pala shitëse nuk i ka shoqërisë asnjë detyrim apo borxh dhe nuk ka bërë asnjë shkelje ligjore në veprimtarinë e shoqërisë nga data që është bërë bashkëortake e deri në datën e sotme të nënshkrimit të kontratës së shitjes, që ka lidhje me cilësinë e saj si bashkëortake.
3. Pala blerëse deklaron se nuk ka asnjë pretendim ndaj palës shitëse, pasi ajo me cilësinë e bashkëortakut ka përmbushur çdo detyrim që ka ortaku në shoqëri dhe se pala shitëse si bashkëortake nuk ka kryer asnjë veprim që të demtojë interesat e shoqërisë dhe nuk do të ngrejë asnjë pretendim ndaj palës shitëse sot e në të ardhmen.
4. Pala blerëse deklaron se ka bërë të gjitha verifikimet dhe se Shoqëria nuk është palë, as nuk është në dijeni të ndonjë rreziku për ndjekje gjyqësore, arbitrazhi, apo administrative, rezultati i së cilës mund të kishte efekt material negativ për shitjen e pjesëve të kapitalit themeltar dhe në dëm të saj, pasi ajo është në dijeni të plotë për veprimtarinë e ortakut që shet, pasi në asnjë rast ortaku me veprimet apo mosveprimet e tij nuk ka sjellë ndonjë dëm, që të rëndojë më pas në kuotat që shiten dhe për pasojë të cëmtohet pala blerëse.
5. Pala shitëse deklaron se nuk mban asnjë përgjegjësi sot dhe në të ardhmen për veprime apo mosveprime të administratorit të shoqërisë, që mund të kenë sjellë deri më sot në datën e nënshkrimit të kontratës, apo mund të sjellin pasoja në të ardhmen për shoqërinë.
6. Pala blerëse deklaron se është plotësisht dakord që të pranojë këtë blerje, kundrejt çmimit të shitjes duke marrë përsipër edhe riskun që mund të ketë përsa parashikohet në pikën 5 neni 4 i kontratës dhe sa më sipër.
7. Pala blerëse është në dijenë të gjitha detyrimeve bankare, ndaj të tretëve, shtetit etj, që ka shoqëria deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe deklaron se nuk ka asnjë pretendim ndaj palës shitëse, që ta detyrojë këtë palë sot dhe në të ardhmen të përgjigjet për këto detyrime.

NENI 5 DETYRIMET NDAJ TË TRETËVE

Pala shitëse deklaron se, deri në këtë datë, nuk ka asnjë detyrim ndaj shoqërisë dhe kuotat që shet janë të lira nga çdo detyrim.



Pala blerëse pranon të blejë 75% të kapitalit themeltar me gjendjen aktive dhe pasive të bilancit të shoqërisë deri në datën e sotme të nënshkrimit të kontratës.

Nëse deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate shoqëria ka detyrime të palikujduara të deklaruarra dhe të padeklaruarra ndaj shtetit, bankave apo kujtdo të treti, pala blerëse merr përsipër detyrimin, duke mos u cënuar pala shitëse në asnjë rast pasi pala shitëse ka përmbushur ndaj shoqërisë cdo detyrim për të cilin pala blerëse deklaron se ka bërë verifikimet.

NENI 6 KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Palëve në lidhje me këtë Kontratë, ose çdo marrëveshje tjetër, ose dokument të zbatuar midis palëve për zbatimin e kësaj Kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim midis Palëve, përndryshe palët i drejtohen Gjykatës kompetente Tiranë.

Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis palëve, në lidhje me çështjet që trajton dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme, qoftë me gojë apo me shkrim, midis palëve.

Pavlefshmëria ose pabazueshmëria e njëres nga dispozitat e kësaj Kontrate nuk do të çënojë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera.

NENI 7 NJOFTIMET

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet mes palëve në këtë kontratë do të bëhen me shkrim në adresat respektive dhe do të konsiderohen si të dhëna në mënyrë të rregullt në rrugë postare dhe/ose elektronike;

Për palën shitëse adresa e e-mail: seb_ho78@yahoo.it.

Për palën blerëse adresa e e-mail: info@fujitsusklima.al

NENI 8 DISPOZITA E FUNDIT

Kjo Kontratë është nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe me të njëjtën vlerë secila në bazë të nenit 705 e vijues të Kodit Civil dhe të Ligjit "Për noterinë" si edhe të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Kontrata iu lexua palëve kontraktuese, të cilat pasi e kuptuan dhe e gjetën sipas vullnetit të tyre të lirë e të plotë, e nënshkruan rregullisht në praninë time.

Bashkangjitur kësaj kontrate:

Ekstrakt i shoqërisë

Certifikatë familjare e pales shitëse

Dokumenta identifikimi të palëve.

PALËT

PALA SHITËSE

Edmond Hoxha



Maria Hoxha



NOTERE
DHIMITRA QARRI



PALA BLERËSE

Elda X. Bregu





SHOQËRIA „SUPERIOR KLIMA“ sh.p.k

VENDIM I ASAMBLESE SË ORTAKËVE

Sot në datën 21.12.2016 mbledhet asambleja e ortakëve të shoqërisë „Superior Klima“ sh.p.k e regjistruar person juridik, e pajisur me nr NIPT-i K91712015L,

pasi morri në shqyrtim rendin e ditës:

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së ortakut Edmond Hoxha për shitjen e të gjithë 75%-it, që ai zotëron në shoqëri, ortakes tjetër znj. Elda Xibraku.
2. Me shitjen e 75% të pjesëve të kapitalit, të zotëruara nga ortaku Edmond Hoxha, shoqëria do të ketë këtë përbërje:

Elda Xibraku, zotëruese e 100% të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Përfaqësues ligjor i shoqërisë do të vazhdojë të jetë z. Ervin Faja, i cili e ushtron detyrën e tij për një periudhë 5 vjeçare nga data e emërimit.
4. Pasqyrimin e këtij vendimi në aktet e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.



ASAMBLEJA E ORTAKËVE

EDMOND HOXHA
Edmond Hoxha

ELDA XIBRAKU
Elda Xibraku